



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



CoDe
institute



MENAXHIMI I MBETURINAVE NË 16 KOMUNA MUNDËSITË PËR BAŞHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL

2016





USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



MENAXHIMI I MBETURINAVE NË 16 KOMUNA MUNDËSITË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL

2016

Financuar nga:

Ky publikim është pjesë e projektit të titulluar: “Forcimi i Bashkëpunimit dhe Partneritetit Zhvillimor Strategjik ndërmjet Komunave/Komuniteteve”. Projekti është pjesë e programit Avancojmë Kosovën së Bashku – Alternativa Lokale i financuar nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe i implementuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF)



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA

**Deklaratë mohimi:**

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të mbështetësve.

Kontribuesit:

Djellza Gashi, Alban Hashani,
Agneta Bytyqi dhe Ilija Mladenović

Dizajni dhe Faqesja:

Faton Selani

Originali është shkruar në anglisht

Publikuar nga:

INSTITUTI RIINVEST
Lidhja e Prizrenit nr. 42
Prishtinë 10000, Republika e Kosovës
Tel: + 381 (0)38 244320; 223816
www.riinvestinstitute.org



PËRMBAJTJA

1. HYRJE 8

2. SITUATA AKTUALE 9

2.1 Niveli komunal 9

2.2 Problemet e përbashkëta 27

3. PRAKTIKAT MË TË MIRA RAJONALE 28

4. MUNDËSITË PËR BASHKËPUNIM
NDËR-KOMUNAL 30

REFERENCAT 31

SHTOJCAT 32



Mbeturinat e prodhuara në Kosovë



0.9 kg/ditë

Mesatarja e mbeturinave për një vit
për person në Kosovë

334 kg.



Sasia e mbeturinave
të prodhuara brenda një
viti në Kosovë

606.000 ton

0.28%

Mbetje të rrezikshme

42.0%

Biodegraduese

12.3%

Tjera

6.75%

Textile

(%)
e mbeturinave
sipas llojit
(2012)

5.59%

Metal

6.57%

Qelq

11.0%


Plastikë

15.0%

Letër /Dru

Sasia e mbeturinave të
prodhuara brenda një viti në
regjionin e Prishtinës

248.000 ton



1. HYRJE

Komunat në Kosovë ballafaqohen me disa probleme të cilat drejtpërdrejtë ndikojnë në performancën e tyre si qeveri lokale. Në një numër relativisht të lartë të rasteve problemet janë të ngjashme në mes të komunave. Edhe pse një numër i komunave kanë filluar të aplikojnë praktika të përmirësuar apo inovative për lokalitetet e tyre, shumë pak është bërë në drejtim të ndarjes së njohurive ose burimeve me komuna të tjera. Me fjalë të tjera, shumë pak bashkëpunime ndër-komunale janë iniciuar në mes komunave. Sipas Asociacionit të Komunave të Kosovës (2010) bashkëpunimi ndër-komunal (BNK) i referohet dy ose më shumë komunave fqinje të cilat punojnë së bashku për të kryer detyrat administrative komunale, për të ofruar shërbime publike për qytetarët dhe për të promovuar zhvillimin lokal në mënyrë më efikase dhe efektive se sa kryerjen e aktiviteteve në mënyrë vetanake. BNK-të në Kosovë janë të pakta dhe jofunksionale në ofrimin e shërbimeve të ndërsjella për qytetarët dhe reduktimin e kostove komunale. Kryesisht komunat bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në raste të veçanta, edhe pse bashkëpunimi i tillë nuk është formal (kontratë, marrëveshje mirëkuptimi) (Asociacioni i Komunave të Kosovës, 2010). Korniza ligjore për BNK-të në Kosovë është e specifikuar në nenin 124 të Kushtetutës, e cila thotë: “Komunat kanë të drejtë për bashkëpunimin ndër-komunal dhe bashkëpunimin ndërkufitar, në pajtim me ligjin”. Për më tepër, Ligji për Vetëqeverisje Lokale specifikon të drejtën e komunave për të bashkëpunuar duke theksuar se “komunat kanë të drejtë të bashkëpunojnë dhe të krijojnë partneritete me komunat tjera të Kosovës për të kryer funksione me interes të përbashkët, në përputhje me parimet e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale dhe në përputhje me ligjin” (Ligji për Vetëqeverisje Lokale, neni 28).

Megjithatë, edhe pse shumë pak është bërë në lidhje me bashkëpunimin ndër-komunal, ka disa mundësi për komunat të bashkojnë ekspertizën dhe përvojat e tyre që së bashku të zgjidhin çështje të përbashkëta. Me kalimin e kohës ky lloj i bashkëpunimit ndër-komunal mund të krijojë themelet për një strategji të zhvillimit të qëndrueshëm komunal që do të inkurajojë komunat për të identifikuar dhe përmbushur nevojat e tyre vetanake të zhvillimit. Kjo gjithashtu inkurajon risi në zgjidhjen e problemeve dhe u jep komunave kapacitetin për të identifikuar dhe adresuar çështjet së bashku dhe në partneritet me komunat e tjera, si dhe me nivelet e larta të qeverisë. Për më tepër, ndarja e kostove do të inkurajohet dhe promovohet në mesin e komunave.

Ky raport është hartuar për të analizuar situatën aktuale lidhur me menaxhimin e mbeturinave në 16 komuna të Kosovës dhe për të propozuar mundësi për bashkëpunim ndër-komunal. Komunat e mbuluara janë Graçanica, Klllokoti, Novobërdë, Parteshi, Ranillug, Shtërpçë, Gjilani, Istogu Klina, Obiliqi, Peja, Vushtrria, Mitrovica e Veriut, Leposaviqi, Zubin Potoku, dhe Zveçani. Objektivi kryesor i këtij raporti është identifikimi i problemeve të përbashkëta me të cilat ballafaqohen komunat në lidhje me menaxhimin e mbeturinave dhe nxjerrja e përgjigjeve të përbashkëta ndaj këtyre problemeve të përbashkëta.

Metodologjia e përdorur për të identifikuar problemet me të cilat përballen komunat lidhur me menaxhimin e mbeturinave ka përfshirë kryerjen e intervistave të detajuara me zyrtarët përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave. Në shumicën e rasteve, ekipi i ka kryer intervistat me drejtorët për shërbime publike dhe me një zyrtar përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave (kur ka pasur një të tillë). Pyetësori për intervista është përpiluar bazuar në një analizë të detajuar të strategjive zhvillimore lokale dhe hulumtimit sekondar që ishte në dispozicion për menaxhimin e mbeturinave në komunat e interesit. Pyetjet kanë qenë të hapura dhe zyrtarët janë inkurajuar për t’iu përgjigjur çdo pyetjeje në detaje. Me pëlqimin e pjesëmarrësve intervistat janë regjistruar dhe transkriptuar. Arsyeja kryesore për regjistrimin e tyre ishte që të mos humbasë asnjë detaj.

Gjetjet nga intervistat tregojnë se ka kryesisht dy forma të bashkëpunimit mes komunave. E para është kompani rajonale që ofrojnë shërbime të menaxhimit të mbeturinave. Forma e dytë është hedhja e mbeturinave në deponi të përbashkëta. Formë tjetër e bashkëpunimit nuk është raportuar nga 16 komunat. Megjithatë, zyrtarët e secilës komunë kanë deklaruar se ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë për përfitimet e qytetarëve.

Pjesa tjetër e raportit është organizuar si më poshtë. Seksioni 2 paraqet, diskuton dhe analizon gjetjet nga intervistat e detajuara me 16 zyrtarë të komunave të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave. I njëjti seksion paraqet problemet e përbashkëta me të cilat ballafaqohen 16 komunat. Seksioni 3 jep praktikatat më të mira të bashkëpunimit ndër-komunal në lidhje me mbeturinat në vendet e rajonit, më konkretisht në Kroaci, Maqedoni, Serbi dhe Mal të Zi. Seksioni 4 paraqet mundësitë e përbashkëta për bashkëpunim ndërmjet komunave.

2. SITUATA AKTUALE

Kjo pjesë e raportit përshkruan situatën aktuale në lidhje me mbeturinat në 16 komunat e Kosovës dhe problemet e përbashkëta me të cilat përballen këto komuna. Analiza është bazuar në informacionin e marrë nga intervistat e detajuara me zyrtarë të komunave të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave.

2.1 NIVELI KOMUNAL



PEJË

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra



Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra

Niveli i ulët i mbledhjes së taksave

Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër



Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit

Në **Pejë**, mbeturinat grumbullohen nga kompania regjionale Ambienti. Është e rëndësishme të përmendet se edhe pse kompania është rajonale ajo funksionon më shumë si një kompani lokale. Komuna e Pejës është 100 përqind pronare e kompanisë dhe ka zgjedhur një bord i cili përbëhet vetëm nga anëtarë të komunës së vet. Kuvendi komunal ka zgjedhur komisionin e aksionarëve dhe komisioni ka zgjedhur bordin dhe drejtorin ekzekutiv i cili i raporton bordit. Bordi raporton te drejtori i shërbimeve publike i cili më pas raporton në kuvendin komunal. Bordi është zgjedhur përmes një thirrje të hapur. Sipas zyrtarëve komunal, rreth 98 përqind e mbeturinave grumbullohet në zonat rurale dhe urbane. Mbeturinat grumbullohen në bazë të planit dinamik lokal dhe kryesisht derë më derë. Ekziston vetëm një pikë grumbulluese e cili është e vendosur afër objektit të kompanisë Ambienti.

Çmimi për shërbimin e ofruar është rreth 5.00 Euro, shumë kjo e njëjtë për të gjithë llojet e konsumatorëve. Zyrtarët komunalë mendojnë se shkalla e sheshtë nuk është e drejtë për klientët dhe si rezultat kanë vendosur të hartojnë një plan për kategorizimin e çmimeve bazuar në llojet e konsumatorëve. Rreth 60 përqind e qytetarëve paguajnë për shërbimin. Mbeturinat deponohen në deponinë regjionale të Pejës në fshatin Sverk. Deponia është e hapur dhe ka një sistem të kullimit. Në vitin 2014 komuna ka investuar në krijimin e një lagune dhe sistemin e pompimit. Megjithatë, kushtet e deponisë janë përkeqësuar vazhdimisht pasi që është përdorur edhe nga komunat tjera. Mbeturinat nuk klasifikohen apo riciklohen por çdo gjë grumbullohet në të njëjtin vend. Në vitin 2013, komuna ka investuar rreth 150.000 Euro në zgjerimin e zonës së deponisë ekzistuese.

Zyrtarët komunal kanë cekur se trajtimi i mbeturinave është proces shumë i kushtue-




Në vitin 2013, komuna ka investuar rreth 150.000 Euro në zgjerimin e zonës së deponisë ekzistuese.



In 2013, the municipality has invested around 150.000 Euros in expanding the area of the existing landfill.

shëm dhe si i tillë komuna nuk i posedon fondet e nevojshme për të investuar. Për më tepër, komuna duhet të investojë në makineri për të mbyllur deponitë ilegale të cilat deri më tani janë pesë, një shumë e madhe dhe katër më të vogla. Deponia e madhe është kryesisht me mbetje inerte dhe heqja e mbeturinave të mbledhura është shumë e kushtueshme. Për shkak të mungesës së fondeve të nevojshme për investime komuna ka organizuar një fushatë ndërgjegjësimi për ndarjen e mbeturinave. Ata gjithashtu janë duke punuar për hartimin e planit për menaxhimin e mbeturinave të financuar nga GIZ.

Zyrtarët komunal kanë cekur se janë të gatshëm për të bashkëpunuar me komunat e tjera lidhur me menaxhimin e mbeturinave.



KLINË

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit

Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave

Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit

Në **Klinë**, njëjtë si në Istog, kompania rajonale Ambienti është përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave. Frekuenca e grumbullimit të mbeturinave ndryshon nga zonat rurale në ato urbane. Në zonat rurale, mbeturinat mblidhen një herë në javë. Në zonat urbane, mbetjet grumbullohen çdo të dytën ditë në zonën kryesore, e cila është në qendër të qytetit, dhe çdo të tretën ditë në zonën e dytë të qytetit. Në zonat rurale shumica e mbeturinave grumbullohen derë më derë. Në zonat urbane, mbeturinat grumbullohen kryesisht në pikat e grumbullimit. Në aspektin e popullsisë, zyrtaret kanë përmendur se rreth 95 përqind e popullsisë shërbehet nga kjo kompani. Të gjitha fshatrave iu ofrohet shërbimi megjithatë ka disa zona ku kamionët nuk mund të arrijnë për shkak të pozitës gjeografike. Klientët paguajnë më pak se 5.00 Euro në muaj për shërbimin dhe rreth 65 deri në 70 përqind e pagesës mblidhet.

Departamenti për shërbime publike në Klinë monitoron aktivitetet e degës Ambienti që ndodhet në këtë komunë. Kuvendi komunal emëron tre anëtarë për të mbikëqyrur shoqërinë. Këta anëtarë janë përgjegjës për monitorimin e aktiviteteve të kompanisë dhe raportimin gjatë takimeve të kuvendit komunal. Megjithatë komuna nuk ka një anëtar të bordit në kompani. Vetëm Peja, si aksionari më i madh i kompanisë ka anëtarë të bordit. Komunat më të vogla si Klina, Istogu, Deçani dhe Juniku nuk kanë anëtar të bordit. Këto komuna mbikëqyrin vetëm njësitë e kompanisë që janë të vendosura në komunat përkatëse.

Mbeturinat deponohen në deponinë rajonale në Pejë e vendosur në fshatin Sverk. Deponia është e hapur dhe ka një sistemin të kulimit. Zyrtarët e komunës kanë deklaruar se deponia duhet të mbyllet dhe një zonë e re duhet të sigurohet. Mbeturinat e hedhura në deponi mbulohen në mënyrë periodike me shtresa të dheut. Asnjë klasifikim paraprak apo riciklim nuk bëhet. Komuna ndihmon




Klientët paguajnë më pak se 5.00 Euro në muaj për shërbimin dhe rreth 65 deri në 70 përqind e pagesës mblidhet.

degën e kompanisë në Klinë për të organizuar fushata vullnetare për të pastruar qytetin. Për më tepër, komuna ka pranuar 2,000 shporta të mbeturinave për familje nga USAID-i. Për sa i përket rregulloreve, komuna e Klinës ka një plan për menaxhimin e mbeturinave; megjithatë, ajo nuk ka një rregullore, por ata janë duke punuar në hartimin e rregullores dhe presin ta kenë gati në fillim të vitit 2016. Për shkak të mungesës së rregullores për menaxhimin e mbeturinave, inspektorët nuk mund të lëshojnë dënime. Për më tepër, komuna nuk ka një inspektor për menaxhimin e mbeturinave. Inspektorët që janë të punësuar në komunë janë të angazhuar në sektorë të tjerë.

Aktualisht, komuna e Klinës bashkëpunon me Pejën pasi që Ambienti është një kompani rajonale e administruar nga Peja, por jo me komunat e tjera në rajon. Kjo komunë është e gatshme për t'u angazhuar në aktivitete ndër-komunale që kontribuojnë në menaxhimin më të mirë dhe trajtimin e mbeturinave. Për më tepër, zyrtarët komunalë kanë propozuar që të organizojnë fushata vetëdijësimi që do të rrisin nivelin e vetëdijësimit të qytetarëve për të reduktuar sasinë e mbeturinave dhe hedhjen e mbeturinave në vendet e caktuara.

ISTOG



Niveli i ulët i vetëdijësisë nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave

Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit



Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit



Në **Istog**, kompania rajonale Ambienti është përgjegjëse për mbledhjen e mbeturinave. Ambienti ofron shërbime në katër komuna të tjera Pejë, Klinë, Deçan dhe Junik. Megjithatë, kompania nuk i ofron shërbimet e saj në të gjithë territorin. Përafërsisht 40 përqind e territorit është e mbuluar; kjo përfshin 12 fshatra dhe qytetin. Kompania nuk mund të mbulojë të gjithë territorin për shkak të mungesës së personelit dhe pajisjeve. Shumica e mbeturinave mbledhen në pikat e grumbullimit. Tarifa prej rreth 5.00 Euro është e ngjashme me komunat tjera. Rreth 70 përqind e pagesave mbledhen. Zyrtarët komunalë kanë përmendur se shkalla e pagesës është më e lartë për familjet e vendosura në fshatra sesa për familjet e vendosur në qytet.

Ambienti është një kompani publike rajonale. Si e tillë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE), në bazë të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, përmes Njesisë për Politika dhe Monitorim, është përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e operacioneve të ndërmarrjeve publike që janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kompania që është përgjegjëse për menaxhimin e deponive është gjithashtu publike dhe monitorohet nga MZHE. Megjithatë, përveç monitorimit të nivelit qendror, departamenti për Shërbime Publike monitoron aktivitetet e kompanisë Ambienti. Monitorimi është i rregulluar me një memorandum mirëkuptimi i cili dikton që çdo komunë mund të monitorojë njësinë/degën e kompanisë që ndodhet në komunën përkatëse. Edhe pse ligjërisht kompania është një kompani rajonale, Istogu nuk ka anëtar në bord. Vetëm Peja, ku ndodhet zyra qendrore, si komuna më e madhe ka anëtarë në bord. Komuna monitoron aktivitetet e njesisë në Istog nëpërmjet një komisioni të përbërë nga tre anëtarë, të cilët janë caktuar nga kuvendi komunal.


Mbeturinat deponohen përkohësisht në deponi lokale të vendosura në Istog. Kjo deponi është përdorur nga komuna si një stacion transferimi që nga viti 2002. Nga ky vend, mbetjet janë



Përafërsisht 40 përqind e territorit është e mbuluar; kjo përfshin 12 fshatra dhe qytetin.

transferuar në deponinë e fundit e cila është e vendosur në fshatin Sverk, Pejë. Deponia e përkohshme në Istog nuk ka një sistem të kullimit për të ndaluar mbeturinat nga ndotja e ujërave nëntokësore. Ndërkohë, deponia në Pejë ka një sistem kullimi megjithatë ky nuk funksionon si duhet. Deponitë operojnë pa përmbushur asnjë nga standardet higjienike. Mbeturinat nuk janë të klasifikuara dhe nuk riciklohen kur hidhen në deponi. Megjithatë, komuna ka në plan të ndërtojë një stacion transferimi në vlerë 0.5 milionë Euro. Toka është siguruar dhe investimi është planifikuar që do të financohet nga qeveria. Komuna ka investuar edhe në hapjen e deponive. Një deponi është hapur në vitin 2009, por ajo është mbyllur ndërkohë. Në vitin 2014, një tjetër deponi është hapur në një vend që është i përshtatshëm për hedhjen e mbeturinave. Këto janë zgjidhje afat-shkurtra vetëm deri sa një stacion transferimi të ndërtohet. Një kompani private ka treguar interes në riciklimin dhe ka kërkuar tokë nga komuna afër stacionit të transferimit i cili planifikohet të ndërtohet. Megjithatë, komuna është duke pritur që kompania të fillojë të investojë. Nëse kompania nuk investon në dy vitet e ardhshme, zyrtarët e komunës do të anulojnë kontratën.

Sa i përket legjislacionit, komuna e Istogut ka miratuar një rregullore për menaxhimin e mbeturinave. Megjithatë, kjo nuk është duke u zbatuar pasi që zbatimi i duhur kërkon një shumë të konsiderueshme të fondeve. Për shkak të mungesës së fondeve të nevojshme rregullorja është duke u zbatuar pjesërisht. Si rezultat i kësaj, ka rreth 28 deponi ilegale në zonën e Istogut.



GJILAN

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët	✗
Deponi të vjetra	✗
Nuk kanë deponi	
Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave	✗
Mungesa e anëtarit të bordit në kompani	
Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave	
Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat	✗
Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat	✗
Mungesa e stacioneve të transferimit	✗
Pajisjet e vjetra	
Niveli i ulët i mbledhjes së taksave	
Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër	✗
Niveli i ulët i mbulimit të territorit	
Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave	
Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit	

Në **Gjiilan** kompania rajonale Eko-Higjiena është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave. Kjo kompani është kompania e parë publiko-private që është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave. Shpeshtësia e mbledhjes së mbeturinave ndryshon. Për familjet, mbeturinat mbledhen një herë në javë, ndërsa në qendër të qytetit mbeturinat mbledhen çdo ditë, zakonisht në kontejnerë të mëdhenj prej 1.1 m³. Kompania është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave në parqet si dhe varrezat e qytetit. Kompania ka pajisje relativisht të reja dhe në krahasim me komunat e tjera të Kosovës ajo qëndron relativisht mirë. Komuna ka marrë edhe 4,200 kontejnerë të rinj si pjesë e një granti. Sa i përket mbulimit, pothuajse i tërë territori i komunës së Gjilanit mbulohet me shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, me përjashtim të disa zonave gjeografike që janë të vështirë për t'u arritur. Pagesa për shërbimin është pak më e ulët se 5.00 Euro dhe sipas zyrtarëve të komunës rreth 76 përqind e pagesës mbledhet.

Edhe pse kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave, Eko-Higjiena, është një kompani publiko-private, struktura organizative është e ngjashme me atë të një kompanie publike. Komiteti i aksionarëve, i cili është i përbërë nga tre anëtarë, zgjidhet nga kuvendi komunal. Përveç aksionarëve, ekziston një bord ekzekutiv ku aksionari më i madh ka të drejtë të ketë një anëtar shtesë. Kompania zotëron 51 përqind, ndërsa komuna zotëron 49 përqind të aksioneve. Kompania është përgjegjëse për raportimin në kuvendin komunal. Sipas zyrtarëve të komunës, ekziston një plan monitorimi në vend i cili përdoret për të monitoruar aktivitetet e kompanisë. Komuna i ka dhënë shërbimin dhe klientelën kompanisë. Tani komuna pret nga kompania që të bëjë punën e saj siç duhet.

Mbeturinat e mbledhura transferohen në deponinë rajonale që gjendet në Gjiilan. E njëjta deponi përdoret nga njëmbëdhjetë komuna të




Pagesa për shërbimin është pak më e ulët se 5.00 Euro dhe sipas zyrtarëve të komunës rreth 76 përqind e pagesës mbledhet.

tjera. Nëse analizohet në aspektin territorial, i bie që deponia përdoret nga 12 përqind e territorit të Kosovës. Deponia është e hapur dhe mbeturinat nuk janë të klasifikuara. Mbeturinat në Gjiilan nuk riciklohen; megjithatë, zyrtarë të komunës kanë deklaruar se Eko-Higjiena ka planifikuar të investojë 1.5 milion në riciklim. Në vitin 2004, zyrtarë të komunës kanë mbyllur një deponi duke mbuluar nëntë hektarë të mbeturinave. Ky ishte një projekt i detajuar. Humusi u përhap shtresë për shtresë dhe pika të ventilimit kanë qenë të vendosura. Pasi procesi u përfundua deponia është shpallur si e mbyllur.

Deponia ekzistuese menaxhohet nga kompania publike përgjegjëse për menaxhimin e deponive. Zyrtarët komunalë e shohin këtë si një problem dhe duan të transferojnë menaxhimin e deponisë tek komuna. Një problem tjetër në të cilin po has komuna është mungesa e burimeve njerëzore të cilat janë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave dhe mungesa e një inspektori i cili inspekton hedhjen e mbeturinave. Pa një njësi të duhur për menaxhimin e mbeturinave, ku të paktën katër persona do të punësohen së bashku me një inspektor, ka pak që mund të bëhet për të ruajtur mjedisin nga hedhja e paligjshme. Sa i përket legjislacionit, përveç planit të monitorimit, komuna është duke hartuar strategjinë për menaxhimin e mbeturinave 2015-2020. Strategjia është pjesë e projektit të mbështetur nga GlZ në Kosovë.

NOVOBËRDË



Niveli i ulët i vetëdijësitimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani



Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat "



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra

Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër



Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit"

Në **Novobërdë**, kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është kompania publike-private nga Gjilani, "Eko-Higjiena". Mbeturinat mbledhen një herë në javë ose më shumë nëse është e nevojshme, dhe transportohen me kamion i cili është në gjendje të mirë. Kompania mbledh rreth 1,680 ton mbeturina në vit. Pjesa më e madhe, 96 përqind, e popullsisë mbulohet nga ky shërbim. Mbeturinat mbledhen në zonat rurale, pasi i gjithë territori i komunës është në fakt një zonë rurale. Kostoja e shërbimit është 5.00 Euro për familje dhe vetëm 37 përqind e familjeve paguajnë këtë tarifë. Mbeturinat deponohen në deponi publike-rajonale që gjendet në Gjilan pa u klasifikuar ose ricikluar fare.

Pasi që kompania është 51 përqind në pronësi private dhe 49 përqind nga komuna e Gjilanit, Novobërda nuk ka të drejtë për të monitoruar atë dhe si rezultat nuk kanë përfaqësues në bord. Mekanizmi i vetëm për të mbrojtur interesat e saj është memorandum i mes komunës dhe kompanisë. Për më tepër, Novobërda siguron zyret për njësitin e kompanisë në komunë dhe mbështet ata duke u regjistruar makinat e tyre.

Deri tani, komuna e Novobërdës nuk ka krijuar ndonjë bashkëpunim me komunat e tjera në lidhje me menaxhimin e mbeturinave. Edhe pse është e interesuar të bashkëpunojë me komunat e tjera, ajo nuk është e interesuar që të ketë një stacion transferimi në territorin e komunës së tij. Nëse stacioni i transferimit do të jetë në ndonjë komunë tjetër, atëherë zyrtarët e komunës do të jenë të interesuar për të bashkëpunuar.


Sa i përket legjislacionit, komuna nuk ka aprovuar ende një rregullore për menaxhimin e mbeturinave.



Kompania mbledh rreth 1,680 ton mbeturina në vit. Pjesa më e madhe, 96 përqind, e popullsisë mbulohet nga ky shërbim.



Pasi që kompania është 51 përqind në pronësi private dhe 49 përqind nga komuna e Gjilanit, Novobërda nuk ka të drejtë për të monitoruar atë dhe si rezultat nuk kanë përfaqësues në bord



PARTESH

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra

Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit



Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit

Në **Partesh**, zyrtarët komunal ofrojnë shërbimin e grumbullimit dhe transportimit të mbeturinave. Sipas ligjit në fuqi, komuna nuk duhet të bëjë mbledhjen e mbeturinave, por pasi që nuk ka asnjë kompani të kontraktuar për këtë punë zyrtarët komunal duhet ta ofrojnë këtë shërbimin. Pasi që ofruesi i shërbimit duhet të ketë një licencë për mbledhjen e mbeturinave, komuna e Parteshit e paguan kompaninë publike-private Eko-Higjienë për licencë. Si shërbim, Eko-Higjienë siguron sistemin e faturimit. Parteshi nuk ka ndonjë përfaqësues në bordin e Eko-Higjienës. Mbeturinat mblidhen katër ditë në javë dhe transportohen nga një kamion që është në gjendje relativisht të mirë. Rreth 4.5 ton mbeturina në ditë mblidhen në komunën e Parteshit.

Për sa i përket mbulueshmërisë, vetëm 17 përqind (160 nga 950) të amvisërive janë të mbuluara nga ky shërbim. Çmimi për këtë shërbim është 3.20 Euro për familje, por vetëm 22 për qind e familjeve paguajnë për shërbimin. Zyrtarët komunalë kanë deklaruar se kanë një plan mujor të operacioneve që ata ndjekin dhe zyrtarët komunal që punojnë në departamentin për shërbime publike monitorojnë nëse plani është duke u zbatuar. Mbeturinat deponohen katër herë në javë në deponinë rajonale publike në Gjilan. Deponia është e hapur dhe mbetjet deponohen pa u klasifikuar. Zyrtarët e komunës kanë deklaruar se departamenti për shërbimet publike i ka bërë kuvendit komunal një propozim për shpërndarjen e tokës që do të përdoret për mbeturina të ndërtimit / rrënojat, plehrat e bagëti dhe kafshëve të ngordhura. Pasi që komuna ofron shërbimet ajo nuk ofron ndonjë mbështetje institucionale, infrastrukture ose financiare për Eko-Higjienën. Komuna paguan vetëm për sistemin e licencës dhe të faturimit.

Meqë Partesh është një komunë relativisht e re, ajo nuk ka krijuar bashkëpunim




Për sa i përket mbulueshmërisë, vetëm 17 përqind (160 nga 950) të amvisërive janë të mbuluara nga ky shërbim. Çmimi për këtë shërbim është 3.20 Euro për familje, por vetëm 22 për qind e familjeve paguajnë për shërbimin.



Meqë Partesh është një komunë relativisht e re, ajo nuk ka krijuar bashkëpunim me ndonjë komunë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve.

me ndonjë komunë në lidhje me menaxhimin e mbetjeve. Megjithatë, zyrtarët kanë deklaruar se ata janë gjithmonë të gatshëm për të bashkëpunuar. Ata janë të interesuar që të krijojnë transferime të stacioneve ku mbetjet mund të klasifikohen dhe të ruhen për një periudhë të kufizuar kohore dhe pastaj të transportohen në qendrat e trajtimit.

Sa i përket legjislacionit, komuna nuk ka aprovuar ende një rregullore për menaxhimin e mbeturinave.



RANILLUG

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave

Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit



Në **Ranillug**, njësoj si në Klokot dhe Partesh, asnjë kompani publike nuk është kontraktuar për të siguruar shërbimin e mbledhjes së mbeturinave. Si e tillë komuna duhet të ofrojë shërbimin vetë. Pasi që ofruesi i shërbimit duhet të ketë një licencë për hedhjen e mbeturinave, komuna paguan Eko-Higjienën për të. Komuna, si ofruese e shërbimeve, ka përgjegjësinë e plotë për menaxhimin e mbeturinave. Punonjësit e departamentit për shërbime publike i raportojnë drejtorit të departamentit për mbarrëvajtjen e shërbimit.


Mbeturinat mbledhen një herë në javë dhe transportohen me kamion të cilin komuna ka marrë si donacion nga USAID-i. Rreth 100 ton mbeturina në muaj mbledhen në Ranillug dhe 100 përqind e popullatës mbulohet nga shërbimi. Çmimi për shërbimin është 3.20 Euro dhe pothuajse 75 përqind e familjeve paguajnë për shërbimin. Mbetjet hidhen në deponinë rajonale publike në Gjilan. Zyrtarët nuk e dine se çfarë ndodh me mbeturinat pasi ato të jenë deponuar. Komuna ka hartuar një plan veprimi për menaxhimin e mbeturinave, por për shkak të kapaciteteve të kufizuara nuk është në gjendje për të zbatuar plotësisht atë.

Për shkak të buxhetit të kufizuar, komuna nuk është në gjendje për të klasifikuar dhe ricikluar mbeturinat. Megjithatë, është një kompani private që mbledh shishe plastike për riciklim. Mungesa e kapaciteteve njerëzore dhe financiare pengojnë Ranillugën nga ndërtimi i një stacion transferimi, ku mbetjet mund të klasifikohen dhe pastaj të transportohen në një objekt të trajtimit.

Zyrtarët komunal kanë cekur se janë të gatshëm për të bashkëpunuar me komunat e tjera lidhur me menaxhimin e mbeturinave.



Rreth 100 ton mbeturina në muaj mbledhen në Ranillug dhe 100 përqind e popullatës mbulohet nga shërbimi. Çmimi për shërbimin është 3.20 Euro dhe pothuajse 75 përqind e familjeve paguajnë për shërbimin. Mbetjet hidhen në deponinë rajonale publike në Gjilan.



KLLOKOT

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra

Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit



Në **Kllokot**, komuna ofron vetë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave pasi që asnjë kompani nuk është e kontraktuar. Megjithatë, pasi që për grumbulluesin e mbeturinave është e nevojshme pajisja me licencë, komuna e paguan kompaninë rajonale Eko-Higjiena, e cila është e bazuar në Gjilan, për licencë. Si kthim, Eko Higjiena siguron sistemin e faturimit. Mbeturinat mblidhen një herë në javë dhe transportohen me një kamion që është në një gjendje teknike relativisht të mirë. Komuna e Kllokotit mbledh në mesatare rreth 980 ton mbeturina në vit.

E gjithë popullata mbulohet nga shërbimi dhe mbeturinat grumbullohen në të gjithë rajonin e Kllokotit. Çmimi për këtë shërbim është 5.00 Euro dhe rreth 50 përqind e konsumatorëve paguajnë. Mbeturinat depozi-tohen pa u klasifikuar në një deponi rajonale e cila gjendet në Gjilan. Pasi që deponia nuk është e vendosur në Kllokot, zyrtarët komunal nuk janë në dijeni se çka ndodh në deponi pasi mbeturinat deponohen. Zyrtarët komunal, të cilët ofrojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave raportojnë tek Drejtori i Departamentit për Shërbime Publike. Ngjashëm me komunat tjera, mbeturinat nuk riciklohen as në Kllokot.

Komuna ka një plan për menaxhimin e mbeturinave por zbatimi i tij nuk është i plotë pasi që kërkohet një shumë e konsiderueshme e mjeteve financiare. Komuna ka nevojë për burime njerëzore dhe financiare për të menaxhuar në mënyrë efikase mbeturinat e prodhuara. Sa i përket bashkëpunimit me komunat e tjera, Kllokot bashkëpunon me komunën e Vitisë, kryesisht për shkëmbim të përvojave, dhe sigurimin e ndihmës në transportin e mbeturinave. Për më tepër, ata kanë diskutuar me zyrtarët e komunave nga Vitia për të ndërtuar një stacion transferi, ku mbetjet mund të klasifikohen, ruhen për një periudhë të kufizuar kohe, dhe transportohen në qendrat e trajtimit, por asnjëra nga komunat nuk i ka poseduar financat e kërkuara.



Komuna e Kllokotit mbledh në mesatare rreth 980 ton mbeturina në vit.




Komuna ofron vetë shërbimin e grumbullimit të mbeturinave pasi që asnjë kompani nuk është e kontraktuar.



Komuna ka një plan për menaxhimin e mbeturinave por zbatimi i tij nuk është i plotë pasi që kërkohet një shumë e konsiderueshme e mjeteve financiare.

SHTËRPCË



Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat "



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit"

Në **Shtërpçë**, kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është Kompania e Re për Shërbime Publike "Shtërpçë". Kjo është një kompani komunale e cila është themeluar dhe ende funksionon në kuadër të sistemit të Republikës së Serbisë. Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunën e Shtërpçës ka përmendur se ata janë në proces të krijimit të një kompanie të re komunale; megjithatë, MZHE ka ndaluar procesin e themelimit të ndërmarrjeve të reja publike për një periudhë kohore.

Mbeturinat mblidhen derë më derë një herë në javë në fshatra dhe dy herë në javë në rrugën kryesore në Shtërpçë. Katër kamionë që janë në gjendje shumë të mirë përdorën për të transportuar mbeturinat. Dy kamionë janë pranuar si donacion nga USAID-i në vitin 2011. Pothuajse 80 përqind e popullatës mbulohet nga ky shërbim (13 nga 15 fshatra). Mbeturinat mblidhen në të gjitha zonat rural. Çmimi për këtë shërbim është 3.00 Euro për familje, por vetëm 40 deri 50 përqind e familjeve në të vërtetë paguajnë për këtë shërbim. Mbeturinat deponohen dy herë në javë në deponinë rajonale në Gjilan dhe herë pas here në stacionin e transferimit në Gërlica / Grlica, Shtërpçë.

Për sa i përket monitorimit, inspektorët e komunës dhe zyrtarë nga Departamenti i Shërbimeve Publike inspektojnë zonat për të parë nëse grumbullohen mbeturinat. Inspektimi bëhet pa ndonjë plan, por në baza ad-hoc. Për më tepër, komuna nuk ka ndonjë plan për menaxhimin e mbeturinave. Komuna paralele që vepron në kuadër të Qeverisë së Republikës së Serbisë ka të drejtë të caktojë bordin mbikëqyrës. Edhe pse kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave nuk është nga Kosova, Komuna e Shtërpçës i ka furnizuar kompaninë me kamionë, dhe paguan regjistrimin dhe mirëmbajtjen e kamionëve. Megjithatë komuna ka një stacion transferimi në Gërlica, ata janë të gatshëm të bashkëpunojnë me komunat tjera në mënyrë që të zvogëlojnë shpenzimet.




Pothuajse 80 përqind e popullatës mbulohet nga ky shërbim (13 nga 15 fshatra).



Mbeturinat deponohen dy herë në javë në deponinë rajonale në Gjilan



Komuna paralele që vepron në kuadër të Qeverisë së Republikës së Serbisë ka të drejtë të caktojë bordin mbikëqyrës.



VUSHTRRI

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra



Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit

Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit



Në **Vushtrri**, kompania regjionale Uniteti është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave. Departamenti për shërbime publike është përgjegjës për hartimin e politikave dhe për t'i ofruar ndihmë kompanisë në ofrimin e shërbimeve efikase. Zyrtarët komunal kanë hartuar planin për menaxhimin e mbeturinave (2016-2020) i cili është miratuar në asamblenë komunale dhe tani komuna është duke kërkuar fonde në mënyrë që të fillohet me zbatimin e planit. Sipas planit për menaxhimin e mbeturinave, një kompani private pritët të kontraktohet për mbledhjen dhe menaxhimin e mbeturinave. Ky vendim është marr për shkak të jo-efikasitetit të kompanisë të shkaktuar nga mungesa e burimeve njerëzore dhe pajisjeve. Rreth 36 ton mbeturina mbledhen në ditë nga Uniteti ndërsa 54 tonë prodhohen në ditë. Një pjesë e mbeturinave grumbullohet derë më derë, ndërsa pjesa tjetër në kontejnerë kolektiv. Zyrtarët komunal nuk kanë statistika të sakta mbi përqindjen e njerëzve që shërbehen me shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Megjithatë, ata kanë informacione të detajuara mbi llojin e mbeturinave të prodhuara dhe të grumbulluara. Deri më tani kompania Uniteti ka shërbyer vetëm një pjesë të qytetit dhe kjo është arsyeja pse komuna ka në plan kontraktimin e një kompanie private për të mbledhur mbeturinat.


Për shërbimin e grumbullimit të mbeturinave, konsumatorët në Vushtrri paguajnë rreth 4.5 Euro. Mirëpo, vetëm 45 përqind e klientëve paguajnë për shërbim. Mbeturinat deponohen në deponinë rajonale që është menaxhuar nga Uniteti. Në rajone të tjera deponitë menaxhohen nga kompania publike përgjegjëse për menaxhimin e deponive (KMDK), ndërsa në Vushtrri deponia menaxhohet nga e njëjta kompani e cila është përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave. Zyrtarët komunal e shohin këtë fakt si një avantazh ndaj komunave tjera. Përveç Obiliqit, Malisheva dhe Skenderaj hedhin mbeturinat e tyre në të njëjtën deponi. Deponia është themeluar në vitin 2001, është e hapur dhe ka një sistem të kullimit. Komuna e Vushtrrisë ka krijuar një partneritet me një komunë në Suedi i cili e ka



Zyrtarët komunal deklaruan se në qoftë se vazhdohet me metodën siç është vepruar për 15 vitet e fundit deponia do të duhet të mbyllet pas 10 viteve.

ndihmuar në krijimin e planit për menaxhimin e mbeturinave. Zyrtarët komunal kanë cekur se zbatimi i ligjit mbi menaxhimin e mbeturinave paraqet një sfidë të madhe për komunat pasi që kërkojnë një shumë e konsiderueshme e fondëve dhe komunat nuk kanë fonde të tilla.

Mbeturinat e hedhur në deponi nuk klasifikohen. Megjithatë, plani për menaxhimin e mbeturinave parasheh mbeturinat të klasifikohen në mënyrë që një pjesë të përdoret për kompostim. Zyrtarët komunal deklaruan se në qoftë se vazhdohet me metodën siç është vepruar për 15 vitet e fundit deponia do të duhet të mbyllet pas 10 viteve. Zyrtarët gjithashtu kanë vënë në dukje se komuna e tyre është një hap përpara nga komunat e tjera pasi që ata kanë ndërtuar një objekt (financuar nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë) për paketimin e mbeturinave të reciklueshme. Objekti është duke u pajisur me makineri. Mirëpo, pasi që Uniteti nuk mund t'i zgjerojë shërbimet e saj në riciklimin, komuna ka vendosur që të kontrakttoj një kompani private e cila do t'i mbledhë mbeturinat, klasifikoj dhe ricikloj. Zyrtarët komunal kanë deklaruar se Prizreni, i cili ka implementuar një projekt katër vjeçar për menaxhimin e mbeturinave të financuar nga Qeveria Japoneze, është marrë si model dhe se ata janë duke u përpjekur që t'i ndjekin hapat e njëjtë. Bashkëpunimi rajonal me komuna të tjera në menaxhimin e mbeturinave konsiderohet si shumë i nevojshëm dhe dobishëm.



OBILIQ

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra



Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave

Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër



Niveli i ulët i mbulimit të territorit



Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit

Në Obiliq, kompania regjionale Pastrimi është përgjegjëse për ofrimin e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave. Përveç Obiliqit, Pastrimi shërben edhe gjashtë komuna tjera: Prishtinën, Fushë Kosovën, Drenasin, Lipjanin, Podujevën dhe Graçanicën. Mbeturinat mbledhen dy herë në javë në zonat urbane dhe një herë në javë në zonat rurale të Obiliqit. Mbeturinat e mbledhura transportohen me kamionë të cilët janë në pronësi të kompanisë regjionale dhe të cilët nuk janë në gjendje të mirë teknike. Dy lloje të kontejnerëve përdoren nga qytetarët për të deponuar mbeturinat, ato kolektive me rreth 10 kub sasi dhe më të vogla me rreth 1.1 kub, si dhe kontejner familjar. Fshatrat janë të pajisura me kontejner prej 1.1 kub të cilat u shërbejnë përafërsisht katër familjeve. Metoda e mbledhjes së mbeturinave ndryshon prej zonave urbane në ato rurale. Në zonat urbane shumica e mbeturinave mbledhen derë më derë. Vetëm dy kontejner kolektiv janë të vendosur në qytet. Në zonat rurale mbeturinat mbledhen në pika grumbulluese.

Prej 18 fshatrave që ka komuna e Obiliqit, në gjashtë ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave dhe pesë janë në proces për tu përfshirë në ofrimin e shërbimit. Kompania nuk mund të ofroj shërbimin në të gjitha komunat për shkak të pozitës gjeografike dhe infrastrukturës rrugore. Janë disa lagje të cilat kanë vetëm katër apo pesë shtëpi të cilat janë të shpërndara larg nga njëra tjetra. Sa i përket popullatës, zyrtarët komunal kanë cekur se rreth 70 përqind të popullatës u ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave. Çmimi për shërbim është 4.60 Euro në muaj dhe rreth 70 përqind e klientëve paguajnë.

Pastrimi është kompani publike regjionale dhe si rezultat Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE) në bazë të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (NR. 03/L-087) përmes Njësisë për Politika dhe Monitorim, mbikëqyrë afarizmin e ndërmarrjeve publike të cilat janë në pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Në Obiliq është zyra regjionale e kompanisë ku janë



Prej 18 fshatrave që ka komuna e Obiliqit, në gjashtë ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave dhe pesë janë në proces për tu përfshirë në ofrimin e shërbimit.



Sa i përket popullatës, zyrtarët komunal kanë cekur se rreth 70 përqind të popullatës u ofrohet shërbimi i mbledhjes së mbeturinave. Çmimi për shërbim është 4.60 Euro në muaj dhe rreth 70 përqind e klientëve paguajnë.

të punësuar rreth 16 punëtor. Komuna ka në pronësi rreth 3 përqind të aksioneve të kompanisë Pastrimi dhe si rezultat e cakton një anëtar të saj në bord. Anëtari i bordit përzgjidhet përmes konkursit i cili publikohet në medime përkatëse. Komisioni i komunës i përbërë nga tre anëtar rekomandon një kandidat i cili votohet në asamblenë komunale. Komuna monitoron aktivitetet e kompanisë përmes anëtarit të bordit. Komuna deri më tani ka investuar në 450 kontejner familjar. Komuna nuk ka ofruar asnjë përkrahje tjetër për kompaninë. Për më tepër, komuna ka ndërprerë financimin e kompanisë pasi që zyrtarët komunal besojnë se kompania

Dy lloje të kontejnerëve
përdoren nga qytetarët
për të deponuar
mbeturinat, ato
kolektive me rreth

10 kub

sasi dhe më të
vogla me rreth

1.1 kub

Fshatrat janë
të pajisura me
kontejner prej
1.1 kub të cilat
u shërbejnë
përafërsisht
katër familjeve.

1.1 cubic

nuk është treguar e drejtë ndaj Obiliqit. Zyrtarët janë të mendimit se kompania ka investuar më shumë në komunat tjera dhe se shumë pak investime janë bërë në komunën e Obiliqit.

Që nga viti 2005, mbeturinat deponohen në deponin regjionale në Mirash, fshat ky i pozicionuar gjeografikisht në komunën e Obiliqit. Kjo deponi përdoret nga gjashtë komuna tjera të cilat i shërben Pastrimi. Lokacioni i deponisë është caktuar nga një vendim i asamblesë komunale. Deponia është e hapur dhe nuk ka sistem të kullimit. Kjo shkakton probleme në ujërat nëntokësore pasi që një pjesë e deponisë noton në ujin e krijuar nga shiu dhe ujërat nëntokësore. Një problem tjetër krijohet nga qentë endacak të cilët sillen rreth deponisë. Deri vonë në komunën e Obiliqit kanë qenë tetë deponi ilegale por pesë janë mbyllur dhe tri janë në proces të mbylljes. Këto deponi janë krijuar kryesisht nga mbeturinat e ndërtimit.

Pas deponimit, mbeturinat nuk klasifikohen apo selektohen. Krejt çka bën kompania për menaxhimin e deponive (KMDK) është të mbulojë mbeturinat me shtresa të dheut. Si rezultat i buxhetit të vogël dhe mungesës së fondeve, komuna e Obiliqit nuk bën riciklimin e mbeturinave. Drejtori për shërbime publike ka cekur se do të duhen dekada për të tejkaluar demin e bërë në Obiliq nga kemikaljet e ndryshme të cilat janë deponuar me vite të tëra dhe vazhdojnë të deponohen në Mirash.

Sa i përket legjislacionit, plani për menaxhimin e mbeturinave është duke u përpiluar si pjesë e një projekti të financuar nga GIZ. Pas aprovimit të planit, do të përpilohet edhe master plani me aktivitete të detajuara. Deri më tani komuna e Obiliqit nuk ka krijuar ndonjë bashkëpunim me komunat tjera. Drejtori i shërbimeve publike beson se Obiliqi është në një disavantazh të madh pasi që deponia është e pozicionuar në komunën e tyre.

Komuna është e gatshme të angazhohet në aktivitete që kontribuojnë në menaxhimin më


“

Fër më tepër, komuna ka ndërprerë financimin e kompanisë pasi që zyrtarët komunal besojnë se kompania nuk është treguar e drejtë ndaj Obiliqit. Zyrtarët janë të mendimit se kompania ka investuar më shumë në komunat tjera dhe se shumë pak investime janë bërë në komunën e Obiliqit.

Drejtori për shërbime publike ka cekur se do të duhen dekada për të tejkaluar demin e bërë në Obiliq nga kemikaljet e ndryshme të cilat janë deponuar me vite të tëra dhe vazhdojnë të deponohen në Mirash.

të mirë dhe trajtimin e mbeturinave. Drejtori për shërbime publike ka përmendur se zyrtarët komunal janë duke menduar për krijimin e një kompanie komunale që do të jetë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave. Në këtë mënyrë komuna e Obiliqit do të jetë pronari i vetëm. Për më tepër, zyrtarë të komunës janë duke negociuar me një investitor nga Gjermania që është i interesuar në prodhimin e energjisë nga mbeturinat.

GRAÇANICË



Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi

Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani



Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër



Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit



Në **Graçanicë**, përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është kompania rajonale Pastrimi. Mbeturinat grumbullohen nga kontejnerët dy herë në javë dhe transportohen në deponi me kamion. Njëri prej kamionëve të përdorur për transportin e mbetjeve është pranuar si donacion nga USAID dhe është në gjendje shumë të keqe. Gjendja e tij është aq e keqe që shoferi dhe koordinatori në krye të kësaj njësie kanë cekur se zor se do të jetë në gjendje të kalojë inspektimin teknik për regjistrimin e ardhshëm. Dy kamionët tjerë të përdorur janë pronë e kompanisë Pastrimi dhe janë në një gjendje pak më të mirë. Sipas zyrtarëve të komunës, rreth 203 ton mbeturina në muaj mblidhen në Graçanicë. Mbeturinat mblidhen në tërë territorin e Graçanicës dhe 100 përqind e popullatës mbulohet nga shërbimi. Cmimi për shërbim është afër 5.00 Euro për familje. Zyrtarët komunal nuk kanë informata të sakta mbi përqindjen e pagesës së inkasuar, por kanë cekur se një numër shumë i vogël i qytetarëve pagujnë për shërbimin.

Komuna ka caktuar një punonjës i cili është përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave dhe monitorimin e punës së njësisë Pastrimi në Graçanicë. Komuna ka pasur një plan të menaxhimit të mbeturinave për vitin 2011 dhe 2012. Që nga mesi i 2015, zyrtarët kanë filluar të punojnë në hartimin e një plani të menaxhimit të mbeturinave me ndihmën e organizatave donatore. Graçanica nuk ka përfaqësues në bordin e kompanisë Pastrimi dhe si rezultat zyrtari komunal i intervistuar nuk ishte në dijeni të procedurave të kërkuara për emërimin e anëtarëve të bordit.

Mbeturinat deponohen në deponinë publike rajonale në Mirash, Obiliq. Zyrtarët komunal nuk janë në dijeni nëse diçka tjetër ndodh me mbeturinat pasi që ato të deponohen pasi që deponia është jashtë territorit të tyre. Aktualisht, në komunën e Graçanicës, ekzistojnë 21 deponi ilegale. Zyrtarët komunal kanë deklaruar se janë duke u përpjekur që ta kthejnë njërin nga deponit ilegale në stacion transferimi. Komuna nuk i posedon fondet dhe burimet njerëzore të nevojshme për riciklimin e mbeturinave. Komuna e Graçanicës,



Sipas zyrtarëve të komunës, rreth 203 ton mbeturina në muaj mblidhen në Graçanicë.




Mbeturinat deponohen në deponinë publike rajonale në Mirash, Obiliq



Aktualisht, në komunën e Graçanicës, ekzistojnë 21 deponi ilegale.

në bazë të një memorandumit në mes të kryetarit të komunës dhe drejtorit ekzekutiv të kompanisë për menaxhimin e mbeturinave, paguan kompaninë Pastrimi rreth 9,828 Euro. Paga përfshin pagat për personelin (koordinatorin, grumbulluesin, dhe shoferin) shpenzimet e karburantit, tarifën për deponimin e mbeturinave, servisimin dhe mirëmbajtjen e automjeteve dhe kontejnerëve.

Sa i përket bashkëpunimit, Graçanica është shumë e interesuar për të ndërtuar një transfer stacioni që mund të përdoret edhe nga komunat tjera. Zyrtarët kanë deklaruar se kanë biseduar me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në lidhje me ndërtimin e transfer stacionit dhe nëse ministria do ta miratonte më lehtë një stacion për dy komuna sesa për një, atëherë ndërtimi i përbashkët kjo do të ishte një mundësi e mirë për të bashkëpunuar.



MITROVICA E VERIUT

Në **Mitrovicën e Veriut**, kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është kompania publike komunale "Standard". Kjo është një kompani publike që është themeluar dhe ende funksionon në kuadër të sistemit të Republikës së Serbisë. Tre vjet më parë, kur u krijua Zyra Administrative e Mitrovicës së Veriut, zyrtarë përkatës kanë propozuar që një kompani private të licencohet për menaxhimin e mbeturinave por asgjë konkrete nuk është ndërmarr.

Mbeturinat mbledhen çdo ditë dhe kryesisht në kontejnerë të mëdhenj. Vetëm në një nga fshatrat nuk është vendosur asnjë kontejnerë dhe qytetarët mbledhin mbeturinat e tyre në qese plastike apo kove, dhe pastaj kompania "Standard" mbledh ato nga venet e caktuara. Kamionët e kompanisë përdoren për të transportuar këto mbeturina. Këta kamionë janë në gjendje shumë të keqe, dhe vetëm një në tre nga këta kamionë është në gjendje të mirë, dy të tjerë janë dëmtuar në masë të madhe. Shërbimi i grumbullimit të mbeturinave mbulon rreth 80 për qind të qytetarëve. Një pjesë e Suhodollit të Epërm mbulohet nga shërbimi i kompanisë nga Mitrovica e Jugut. Çmimi për shërbimin është rreth 3.00 Euro për familje, por rreth 99 për qind e qytetarëve nuk paguajnë për këtë shërbim.

Zyrtarisht komuna nuk ka ndonjë mekanizëm për të mbrojtur interesat e saj. Komuna paralele që vepron në kuadër të Qeverisë së Republikës së Serbisë është përgjegjëse për monitorimin e kompanisë dhe ka të drejtë për të emëruar bordin mbikëqyrës. Bashkëpunimi me komunën e re është në nivel jozyrtar.

Momentalisht mbetjet transportohen në Zubin Potok pasi që është e vetmja deponi funksionale në atë pjesë. Tarifa standarde paguhet për deponimin e mbeturinave. Procesi i vetëm i përzgjedhjes që është bërë është ajo e ndarjes së mbeturinave mjekësore nga llojet e tjera të mbeturinave. Zyrtari i intervistuar nuk ka pasur asnjë infor-

macion se çfarë ndodh me mbeturinat pasi ato të deponohen.

Komuna nuk bashkëpunon me kompaninë në fjalë në nivel zyrtar. Megjithatë, ata janë duke planifikuar për të blerë dy kamionë për grumbullimin e mbeturinave. Blerja e kamionëve do të jetë mbështetja e parë financiare. Përveç kamionëve, komuna ka pasur një varg të aktiviteteve të përbashkëta për pastrimin e lumit Ibër, ku kompania Standard është angazhuar për të mbledhur mbeturinat.

Komuna ka hartuar një Plan Lokal për Menaxhimin e Mbeturinave, por ai nuk është miratuar ende. Arsyeja për këtë është se kuvendi komunal është themeluar rishtazi. Ky plan është duke u zbatuar në thelb me përjashtim të pjesës së klasifikimit. Ai nuk është zbatuar plotësisht për shkak të mungesës së kapaciteteve, mungesës së fondeve dhe infrastrukturës. Një aktivitet tjetër i paraparë në këtë plan është ndërtimi i një stacioni transferimi për klasifikimin e mbeturinave.

Mitrovica Veriore bashkëpunon me komunën e Zubin Potokut për deponimin e mbeturinave të vendosura në territorin e tyre. Më parë, ata kanë bashkëpunuar me Zveçanin, për shkak se deponia e mëparshme ishte në territorin e tyre. Kjo deponi ishte në tokë private dhe Mitrovicës së Veriut i është dashur të paguajë një tarifë, prandaj komuna ka vendosur të zhvendos deponinë në Zubin Potok. Ata janë gjithashtu të gatshëm për të bashkëpunuar me Mitrovicën e Jugut, në mënyrë që të përdorin deponinë e licencuar në Koshutov.

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi



Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave




Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit





LEPOSAVIQ

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi



Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit

Në **Leposaviq**, përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është kompania publike komunale "24 Nëntori". Kjo kompani është themeluar nga komuna paralele në Leposaviq. Komuna paralele që vepron nën Qeverinë e Republikës së Serbisë është përgjegjëse për kompaninë dhe si e tillë ajo ka të drejtë të caktojë bordin mbikëqyrës.

Në zonën urbane të Leposaviqit mbeturinat grumbullohen çdo ditë, ndërsa në fshatra dhe rreth qytetit tri herë në javë. Në zonat rurale, mbeturinat mblidhen një herë në javë. Gjatë një dite rreth 15 ton mbeturina mblidhen nga kontejnerët. Rreth 65 përqind të qytetarëve u ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, duke përfshirë edhe zonat rurale. Zyrtarët komunal kanë deklaruar se çmimi për shërbimin varet nga sipërfaqja e shtëpisë/banesës. Megjithatë, asnjë nga konsumatorët nuk paguajnë për shërbimin.

Deri në fund të vitit 2012, mbeturinat janë deponuar në deponinë në fshatin Ballaban, Zveçan. Megjithatë, pas mbylljes së deponisë, Leposaviqi ka ndërtuar deponinë e vet lokale. Ndërtimi i deponisë nuk është bazuar në ndonjë rregullore ose standard dhe nuk ka sistem të kullimit, por komuna nuk kanë pasur ndonjë zgjidhje tjetër. Mbeturinat e hedhur në deponi nuk klasifikohen ose riciklohen. Pas deponimit, mbeturinat mbulohen me shtresa të dheut. Ky proces përsëritet vazhdimisht. Kompania është përpjekur të rrisë ndërgjegjësimin e qytetarëve për të minimizuar sasinë e mbeturinave, mirëpo, sipas zyrtarëve komunal, pa pasur pajisjet e duhura dhe burimet njerëzore, rritja e vetëdijes së qytetarëve ka pak kuptim. Sa i përket bashkëpunimit, zyrtarët komunal kanë cekur se një mundësi do të ishte krijimi i një deponie të përbashkët që do të përdoret nga Leposaviq, Zveçani dhe Mitrovica Veriore. Megjithatë, ata janë të hapur për bashkëpunim edhe me komunat e tjera.




Rreth 65 përqind të qytetarëve u ofrohet shërbimi i grumbullimit të mbeturinave, duke përfshirë edhe zonat rurale.



Përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është kompania publike komunale "24 Nëntori". Kjo kompani është themeluar nga komuna paralele në Leposaviq

Sa i përket legjislacionit, komuna nuk ka aprovuar ende ndonjë rregullore për menaxhimin e mbeturinave



ZVEÇAN

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra



Nuk kanë deponi



Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat "



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit



Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave

Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit"

Në **Zveçan**, kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është Kompania Publike Komunale "Zveçan". Komuna paralele që vepron në kuadër të Qeverisë së Republikës së Serbisë është përgjegjëse për monitorimin e kompanisë dhe ka të drejtë për të emëruar anëtarët e bordit mbikëqyrës. Kompania është mbështetur financiarisht nga buxheti që komuna paralele e merr nga Qeveria e Republikës së Serbisë.

Në Zveçan mbeturinat mblidhen për çdo ditë, dhe një herë në javë në fshatrat përreth. Dy kamionë që janë në gjendje të mirë përdoren për të transportuar mbetjet. Rreth 70 deri 80 përqind e qytetarëve marrin këtë shërbim. Kostoja e shërbimit është rreth 2.00 Euro për familje dhe 80 përqind është pagesa totale e mbledhur. Komuna e Zveçanit nuk ka ndonjë deponi. Në këtë moment, komuna është duke përdorur një vend të përkohshëm për grumbullimin e mbeturinave. Ky vend grumbullimi ka disa shtresa argjile që shërbejnë si drenazh. Pasi që hidhen në vend grumbullim, mbeturinat janë të mbuluara me shtresa të dheut. Komuna nuk ka një plan apo strategji për menaxhimin e mbeturinave.


Zyrtarët e komunës kanë deklaruar se kanë aplikuar për fonde së bashku me Komunën e Mitrovicës Veriore, Zubin Potokut dhe Leposaviqit për një projekt të përbashkët rajonal të menaxhimit të mbeturinave. Një nga aktivitetet e projektit është ndërtimi i një deponie në territorin e Zveçanit. Zyrtarët komunal janë gjithashtu të interesuar për të bashkëpunuar në ndërtimin e një stacioni transferimi.



Kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është Kompania Publike Komunale "Zveçan". Komuna paralele që vepron në kuadër të Qeverisë së Republikës së Serbisë është përgjegjëse për monitorimin e kompanisë dhe ka të drejtë për të emëruar anëtarët e bordit mbikëqyrës



Komuna e Zveçanit nuk ka ndonjë deponi. Në këtë moment, komuna është duke përdorur një vend të përkohshëm për grumbullimin e mbeturinave. Ky vend grumbullimi ka disa shtresa argjile që shërbejnë si drenazh.



ZUBIN POTOK

Niveli i ulët i vetëdijësimit nga qytetarët



Deponi të vjetra

Nuk kanë deponi



Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave



Mungesa e anëtarit të bordit në kompani

Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave



Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat



Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat



Mungesa e stacioneve të transferimit

Pajisjet e vjetra



Niveli i ulët i mbledhjes së taksave



Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër

Niveli i ulët i mbulimit të territorit

Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave

Mungesa e burimeve financiare për zbatimin e planit

Në **Zubin Potok**, kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është Kompania Publike Komunale "Zubin Potok", e cila është themeluar nga komuna paralele. Pasi që kompania është në pronësi të një institucioni paralel, komuna e Zubin Potokut nuk ka ndonjë mekanizëm për të mbrojtur interesat e saj. Komuna që vepron në kuadër të Qeverisë së Republikës së Serbisë është përgjegjëse për monitorimin e kompanisë dhe ka të drejtë për të emëruar bordin mbikëqyrës.

Mbeturinat mbledhen një herë në javë dhe kamionët e përdorur për të transportuar mbetjet janë në gjendje relativisht të mirë. Rreth 15 metra kub mbeturina mbledhen për çdo javë. Rreth 70 në 80 përqind e qytetarëve janë të mbuluar nga ky shërbim. Çmimi i shërbimit është rreth 3.00 Euro për familje, megjithatë, një numër shumë i vogël i qytetarëve paguajnë këtë tarifë. Zyrtarët komunal nuk kanë informata mbi përqindjen e pagesës së inkasuar.

Pas mbledhjes së mbeturinave, mbeturinat transportohen në deponinë pranë liqenit të Gazivodës. Kjo deponi është specifike për shkak se nuk ka sistem të kullimit, por sipërfaqja është e tillë që uji nuk rrjedhje dhe si rezultat nuk e ndot tokën dhe ujërat nëntokësore. Në këtë deponi bëhet klasifikimi i pjesshëm dhe riciklimi i plastikës dhe letrës. Riciklimi është i pjesshëm për shkak të mungesës së pajisjeve të nevojshme për të përfunduar procesin. Mbeturinat e deponuara mbulohen çdo 15 ditë me shtresa të dheut.

Zyrtarët komunalë kanë cekur se janë të gatshëm të bashkëpunojnë me komunat tjera për menaxhimin e mbeturinave. Ata kanë një deponi dhe ata do të jenë të interesuar për të ndërtuar një stacion transferimi së bashku me ndonjë komunë tjetër.

Sa i përket legjislacionit, komuna nuk ka aprovuar ende ndonjë rregullore për menaxhimin e mbeturinave



Rreth 15 metra kub mbeturina mbledhen për çdo javë. Rreth 70 në 80 përqind e qytetarëve janë të mbuluar nga ky shërbim. Çmimi i shërbimit është rreth 3.00 Euro për familje, megjithatë, një numër shumë i vogël i qytetarëve paguajnë këtë tarifë.



Kompania përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave është Kompania Publike Komunale "Zubin Potok", e cila është themeluar nga komuna paralele.

2.2 Problemet e përbashkëta

Nga analizat e bëra në seksionin e mëparshëm mund të vijmë në përfundim të qartë se gjashtëmbëdhjetë komuna përballen me disa sfida sa i përket menaxhimit të mbeturinave. Për më tepër, shumica e problemeve me të cilat ballafaqohen komunat janë të ngjashme për nga natyra. Kjo është veçanërisht e vërtetë për komunat në të cilat e njëjta kompani rajonale ofron shërbimin e grumbullimit të mbeturinave dhe për komunat që deponojnë mbeturinat në të njëjtën deponi. Probleme të përbashkëta dalin në një masë të madhe nga komunat e reja që janë krijuar si rezultat i procesit të decentralizimit. Nga intervistat dhe analizat e thukëta, ekipi ka arritur të identifikojë 15 probleme të shpërndara për komuna. Për të marrë më shumë informacion për komunat që ndajnë problemet e përbashkëta, referohuni në Tabelën 1 në Shtojcën 1 (Shënim: Problemet nuk janë renditur në bazë të rëndësisë).

Problemi i parë me të cilin përballen shumë komuna është niveli i ulët i ndërgjegjësimit të qytetarëve në lidhje me hedhjen e mbeturinave, reduktimin e mbeturinave, ripërdorimin e mbeturinave dhe riciklimin e mbeturinave. Pothuajse të gjithë zyrtarët e komunal janë ankuar se qytetarët nuk janë të kujdesshëm gjatë hedhjes së mbeturinave, sidomos ata që jetojnë në zonat urbane. Për më tepër, qytetarët nxjerrin një nivel të lartë të mbeturinave dhe nuk janë të vetëdijshëm se ata mund të zvogëlojë sasinë e mbeturinave nga ripërdorimi dhe riciklimi i tyre. Problemi i dytë me të cilin përballen janë deponitë e vjetra të cilat janë në kushte të përkeqësuar. Shumicës së këtyre deponive iu mungojnë sistemet e kullimit e si rrjedhojë ndotin ujin nëntokësor. Problemi i tretë, i lidhur me deponitë është menaxhimi i tyre. Shumica e deponive janë të menaxhuara nga kompanitë publike përgjegjëse për menaxhimin e deponive rajonale, me përjashtim të njëres në Vushtrri e cila menaxhohet nga kompania përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave. Kjo shihet si shumë problematike për komunat dhe do të ishte më mirë nëse komuna apo kompanitë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave të menaxhojnë deponitë e veçanta.

Problemi i katërt me të cilat përballen disa komuna, sidomos ato në pjesën veriore të Kosovës, është mungesa e deponive. Tri komunat veriore, Mitrovica e Veriut, Zveçani dhe Zubin Potok nuk kanë deponi. Leposavic ka një deponi, por është ndërtuar pa asnjë standard. Problemi i pestë është mungesa e një kompanie të kontraktuar për menaxhimin e mbeturinave. Ky problem është i shfaqur kryesisht në komunat më të vogla të tilla si Partesh, Kllokot dhe Ranillug, të cilat ofrojnë këto shërbime vetë. Problemi i gjashtë është pamundësia për të siguruar mbrojtjen e interesave pasi që komunat më të vogla nuk kanë përfaqësueses në bordin e kompanive rajonale të menaxhimit të mbeturinave. Një problem tjetër i lidhur me anëtarët e

bordit është i aplikueshëm tek komunat serbe me shumicë, ku kompanitë përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave janë të krijuara nga komunat paralele serbe. Këto komuna janë përgjegjëse për grumbullimin e mbeturinave dhe kanë të drejtë të caktojnë anëtarët e bordit.

Problemi i shtatë është niveli i ulët i grumbullimit të mbeturinave. Zakonisht më shumë mbeturina prodhohen se sa që mblidhen dhe kjo ndodh për shkak të kapaciteteve të kufizuara. Problemi i tetë janë pajisjet e vjetruara të përdorura për të transportuar mbeturinat. Shumë komuna ankohen se kamionët e përdorur janë në gjendje shumë të keqe. Problemi i nëntë është mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat. Mbeturinat depozitohen në tokë pa u klasifikuar. Problemi i dhjetë është mungesa e mjeteve për riciklimin e mbeturinave. Ngjashëm me problemin e tetë, mbeturinat depozitohen në deponi dhe mbulohen nga shtresat e dheut. Problemi i njëmbëdhjetë me të cilin ballafaqohen komunat është mungesa e stacioneve të transferimit, ku mbetjet mund të klasifikohen në mënyrë që të ripërdoren dhe riciklohen.

Problemi i dymbëdhjetë që haset është niveli i ulët i mbledhjes së taksave. Shkalla e mbledhja së taksave varion nga 0 në 80 për qind. Zakonisht në komunat veriore, qytetarët nuk paguajnë për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Në komunat e tjera më të vogla, mbledhja varion nga 17 në 40 përqind. Në komunat më të mëdha të tilla si: Gjilan, Pejë, Istog dhe Klinë, mbledhja shkon deri në 70 përqind. Problemi i trembëdhjetë është niveli i ulët i mbulueshmërisë me shërbimin. Në disa komuna vetëm 20 për qind e territorit është e mbuluar me shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Problemi i katërmëdhjetë me të cilin ballafaqohet komuna është mungesa e një plani të menaxhimit të mbeturinave. Problemi i fundit i identifikuar është paaftësia për zbatimin e planit të menaxhimit të mbeturinave për shkak të mungesës së burimeve financiare.

Problemi i dymbëdhjetë me të cilin ballafaqohen komunat është niveli i ulët i mbledhjes së taksave. Shkalla e mbledhjes së taksave varion nga 0 deri në 80 përqind. Zakonisht në komunat veriore, qytetarët nuk paguajnë për shërbimet e grumbullimit të mbeturinave. Në komunat e tjera më të vogla, mbledhja varion nga 17 në 40 përqind. Në komunat më të mëdha si: Gjilan, Pejë, Istog dhe Klinë, mbledhja shkon deri në 70 përqind. Problemi trembëdhjetë është niveli i ulët i mbulimit me shërbim. Në disa komuna vetëm 20 përqind e territorit mbulohet nga shërbimi i grumbullimit të mbeturinave. Problemi i katërmëdhjetë me të cilat ballafaqohet komuna është mungesa e një plani të menaxhimit të mbeturinave. Problemi i fundit i identifikuar është pamundësia për zbatimin e planit të menaxhimit të mbeturinave për shkak të mungesës së burimeve financiare.

3. PRAKTIKAT MË TË MIRA RAJONALE

Në mënyrë që të mësohet nga praktikat më të mira të përdorura në rajon, ekipi realizoi hulumtim dytësor dhe vendosi të prezantojë rastet më të mira të bashkëpunimit në menaxhimin e mbeturinave. Në Kroaci, grumbullimi i përbashkët dhe deponimi i mbeturinave komunale është një prej formave më të përdorura mes qeverive lokale (Asociacioni i Komunave të Republikës së Kroacisë, 2010). Bashkëpunimi është kryesisht i pa-institucionalizuar dhe i definuar nga Ligji për Ekonomi Komunale, dhe i referohet vendosjes së policisë së përbashkët komunale dhe kontratave të partneritetit publiko-privat mes kompanisë private dhe disa qeverive lokale, me pëlqimin paraprak të ministrisë përgjegjëse për çështje të kontratës. Forma kryesore e bashkëpunimit është përmes ndërmarrjeve të përbashkëta komunale ku qeveritë lokale janë bashkë-pronarë të ndërmarrjes (Asociacioni i Komunave të Republikës së Kroacisë, 2010).

Në Maqedoni për shkak të mungesës së një sistemi të grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave të ngurta, hedhjes së egër, resurseve të pamjaftueshme të komunave për të mundësuar shërbimet individualisht, mungesës së sistemit për grumbullimin e mbeturinave infektuese/mjekësore si dhe atyre të rrezikshme industriale, 35 komuna jug-perëndimore kanë arritur një marrëveshje për të krijuar një fabrikë të përbashkët të mbeturinave (Local Development Group, 2006). Projekti shtrihet në një hapësirë prej 7,299 km² dhe mbulon qytetin e Bitolës, Ohrit, Prilepit, Resenit, Strugës, me një numër rreth 430,000 banorë (Local Development Group, 2006). Nga fabrika e mbeturinave të ngurta, komunat presin të minimizojnë rreziqet ndaj publikut që mund të shkaktohen nga manovrimi i mbeturinave, të përmirësojnë kushtet mjedisore në të gjithë zonën, të zhvillojnë turizmin, të mbrojnë resurset natyrore, dhe të zvogëlojnë efektet negative të mbeturinave të shpërndara. Objektivi i projektit të propozuar është si pasojë e krijimit të një sistemi të gjerë-zonal për grumbullimin dhe deponimin e përshtatshëm të mbeturinave komunale dhe atyre industriale të pa-rrezikshme (OSCE, 2014). Komponenti kryesor i projektit të propozuar është krijimi i një deponie sanitare moderne për të gjithë rajonin e projektit. Për të ju mundësuar qasje të barabartë të gjitha komunave në fabrikën e re, pavarësisht lokacionit të tyre fizik në zonën rajonale dhe distancës me deponinë e re, koncepti i një-deponije është plotësuar me një sistem logjistik i cili manovrohet nga operatori i deponisë. Sistemi

logjistik përbëhet nga stacionet e transferimit dhe pikat e vogla të transferimit, kontejnerë, kontejnerë që vendosen në kamion, dhe kamionë të gjatë të cilët përdoren për grumbullim dhe të cilët operojnë në hapësirën e projektit për të mbledhur mbeturinat nga kolektorët në një distancë të përshtatshme nga hapësira e grumbullimit të mbeturinave. Krahësuar me krijimin e deponive më të vogla në nën-rajonet e zonës së projektit, në afërsi të qendrave të popullsisë, ky kombinim ka dalë të jetë zgjidhja më kost-efikase për zonën e projektit. Trajtimi i mbeturinave dhe fabrikave ricikluese janë përfshirë në dizajnimin e sistemit, aq sa është ekonomikisht e qëndrueshme për momentin (OSCE, 2004). Për të minimizuar distancën që duhet udhëtuar nga automjetet e grumbullimit në mes të hapësirës grumbulluese dhe objekteve të deponive, tre (nën) stacione transferuese rajonale janë paraparë të pranojnë përpos deponive, mbeturinat e grumbulluara në pesë qytetet kryesore të zonës (dy prej tyre të vendosura në distancë të afërt me njëra tjetrën). Për më shumë, 7 pika të thjeshta transferimi ju shërbejnë qyteteve më të vogla me shërbimet e grumbullimit në vend, ku janë paraparë shtatë stacione të thjeshta transferimi, të përbërë nga 40 m³ kontejnerë lëvizës, të vendosur në një pjerrtësi e cila ju mundëson veturave të grumbullimit të hedhin mbeturinat e grumbulluara në kontejnerë (OSCE, 2004). Bashkëpunimi komunal është vendosur si një asociacion i partnerëve, ku komunat dhe një ndërmarrës privat janë partnerë. Ndërmarrësi privat është paraparë të jetë “operatori” i sistemit i cili përfshin transferimin e stacioneve në deponi. Funksioni aktual i grumbullimit të mbeturinave do të mbetet me komunat individuale, përderisa transporti i distancës së gjatë dhe deponimi i mbeturinave duhet të realizohet nga një entitet i ri, i formuar për këtë qëllim. Komunat do të marrin pronësinë e organizimit të asgjësimit. Komunat do të paguajnë asociacionit tarifat për operimin, ndërsa asociacioni do të paguajë operatorin (Local Development Group, 2006).

Në Serbi, shtatë komuna (Subotica, Backi Topoli, Kanjiza, Senta, Mali Idjos, Çoka dhe Novi Knezevac) kanë investuar në ndërtimin e një deponie rajonale në Suboticë. Përveç komunave, projekti është financuar edhe nga Bashkimi Evropian. Ndërtimi është paraparë të përfundojë në fund të 2017-tës. Lokacioni i planifikuar i deponisë rajonale Subotica mbështetet në një rrugë lokale Suboticë-Bikovë-Orom,

shtatë kilometra nga Subotica në drejtim jug-lindor. Fshatrat më të afërta në lidhje me deponinë e parashikuar rajonale janë Gabriçi dhe Oromo, të vendosur dy kilometra larg vendit. Hapësira në dispozicion për ndërtimin e deponisë rajonale është 46 hektarë. Objektivi kryesor i projektit është ndërtimi i një deponie rajonale komunale për mbeturina, duke përfshirë të gjitha pajisjet stacionare, të cilat i plotësojnë Direktivat e Deponisë të BE-së 1999/31/EC, duke ju shërbyer shtatë komunave me një popullsi prej 280,025. Hapësira totale shërbyese e deponisë do të mbulojë 46 hektarë dhe kapaciteti total do të jetë 2,906,000 tonë deri në vitin 2042. Objektivi tjetër është ndërtimi i katër stacioneve transferuese për optimizimin e skemës së transportit në distancë prej 20-30 km. Stacionet e transferimit do të vendosen në komunat e Suboticës, Bačka Topolës, Sentës dhe Kanjizës.

Në Mal të Zi bashkëpunimi ndër-komunal është nxitur po ashtu. Një prej shumë fushave në të cilat komunat e Malit të Zi ka bashkëpunuar është krijimi i deponive rajonale dhe qendrave të riciklimit. Komunat si Andrijeviça, Bëran, Rozhaja, Plava, kanë ndërtuar një deponi rajonale dhe qendër ricikluese. Bijelo Polje, Mojkovaci dhe Kolashini, po ashtu kanë ndërtuar një deponi rajonale. Nikshiqi, Shavniku dhe Pluzhina kanë bashkëpunuar duke ndërtuar një deponi rajonale (UNDP Montenegro, 2010).

Në Shqipëri, një anketë e realizuar në mënyrë që të krijojë një inventar të bashkëpunimeve ndër-komunale ka identifikuar mes 24 dhe 37 marrëveshje me shkallë të ndryshme të formalizimit mes njësive të ndryshme të qeverive lokale (Institute for Democracy and Mediation, 2013). Një formë e bashkëpunimit ndër-komunal është Asociacioni Ndër-Komunal i Zadrimës për menaxhimin e mbeturinave. Zadrima është krijuar si organizatë jo-profitabile duke mbuluar territorin e pesë njësive lokale qeverisëse të cilat janë të vendosura në pjesën veri-lindore të Shqipërisë. Popullsia totale e pesë njësive qeverisëse lokale e cila po shërbehet është 55,190 banorë. Qëllimi kryesor i Asociacionit Ndër-Komunal të Zadrimës është të inkurajojë zhvillimin social dhe ekonomik të Zadrimës përmes intervenimeve të koordinuara mes anëtarëve. Asociacioni mund të performojë detyra sipas Statutit vetëm nëse autorizohet nga shumica e anëtarëve të tij. Fushat e kompetencës variojnë përmes sektorëve ekonomikë dhe urban, por asociacioni

është kryesisht i ngarkuar me menaxhimin e përbashkët të sistemit rajonal të mbeturinave. Stafi është i përbërë nga Presidenti i Asociacionit Ndër-Komunal, i cili menaxhon aktivitetet operative, një person përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave i cili monitoron performancën për këtë shërbim publik dhe tre punëtorë të angazhuar në grumbullimin e mbeturinave kur shërbimi ofrohet në fushat e targetuara. Komiteti drejtues i cili përbëhet nga kryetarët e pesë njësive qeverisëse lokale, është trupi vendim-marrës i Asociacionit. Anëtarët e paguajnë Asociacionit një tarifë anëtarësimi dhe një tarifë vjetore për të mbuluar shpenzimet e grumbullimit të mbeturinave dhe shërbimet menaxheriale (Institute for Democracy and Mediation, 2013). Implementimi i bashkëpunimit ndër-komunal ka kontribuar në zvogëlimin e shpenzimeve, në ngritjen e zonës së mbulimit shërbyes, dhe përmirësimin e performancës financiare (Institute for Democracy and Mediation, 2013). Të pesë njësitë qeverisëse lokale ndajnë shpenzimet e investimeve kapitale, shpenzimet operacionale dhe ato të personelit. Kjo ka rezultuar në një zvogëlim të dukshëm të kostove krahasuar me atë nëse shërbimi do të ofrohej nga secila njësi me resurset e tyre të limituara. Kostot e grumbullimit të mbeturinave, transportimit dhe deponimit janë për 2.5 herë më të vogla nëse ofrohen përmes bashkëpunimit ndër-komunal (Institute for Democracy and Mediation, 2013).

4. MUNDËSITË PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL

Pasi që komunat ndajnë shumë probleme të përbashkëta lidhur me menaxhimin e mbeturinave, mundësitë për krijimin e bashkëpunimit ndër-rajonal në mënyrë që të projektohen zgjidhjet e përbashkëta, janë të shumta.

1

Një formë e bashkëpunimit mund të bazohet në afërsinë gjeografike. Komunat e veriut të Kosovës, Mitrovica Veriore, Leposaviqi dhe Zveqani, mund të krijojnë një deponi të përbashkët dhe ta përdorin për qëllimet e tyre. Nëse kapaciteti i deponisë që do të ndërtohet është i madh, komunat tjera mund ta shfrytëzojnë po ashtu. Komunat tjera mund të paguajnë një tarifë për përdorimin e deponisë. Nga forumi mbi Menaxhimin e Mbeturinave të organizuar në fund të muajit Shkurt 2016, ëdhtë nxjerr si konkludim se komuna e Zubin Potokut është gjeografikisht më larg nga tri komunat tjera veriore dhe si rezultat nuk mund të përdorë deponinë e njejtë.

2

Një mënyrë tjetër përmes së cilës mund të bashkëpunojnë komunat e veriut është përmes ndërtimit të një stacioni të përbashkët të transferimit ku mbeturinat mund të klasifikohen, dhe pastaj të dërgohen në qendrat e trajtimit. Strategjia kombëtare për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022 parasheh krijimin e gjashtë qendrave trajtuese. Stacioni i transferit mund të themelohet edhe nga komunat tjera po ashtu. Gjilani, për shembull shërbehet nga një kompani publiko-private e cila planifikon të angazhohet në riciklim. Komunat afër njëra tjetrës mund të bashkëpunojnë për të ndërtuar një stacion të përbashkët transferimi. Mbeturinat e klasifikuara në stacionet e transferimit mund të dërgohen në qendrat e riciklimit në të cilat kompania do të investojë, ose në qendrat e trajtimit të cilat i parasheh strategjia kombëtare.

3

Një tjetër mundësi për një stacion të përbashkët transferimi është në komunat perëndimorë të Kosovës si Istogu, Klina, Peja, Deçani dhe Juniku. Komuna e Istogut po planifikon të ndërtojë një stacion transferimi dhe si të tillë komunat mund ta përdorin për të klasifikuar mbeturinat. Në Istog një kompani private ka shfaqur interesim në riciklim dhe ka kërkuar tokë dhe pronë nga komuna, e cila është afër me stacionin e transferimit i cili është i planifikuar të ndërtohet. Mbeturinat nga stacioni i transferimit mund të dërgohen në objektin e riciklimit ose qendrat e trajtimit.

4

Komunave me shumicë serbe ju ofrohet shërbimi nga institucionet paralele. Në mënyrë që të shmangim këtë dukuri, komunat mund të krijojnë një kompani publike rajonale e cila do të ishte përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave. Ajo kompani po ashtu mund të menaxhojë deponinë rajonale e cila do të përdoret nga komunat me shumicë serbe. Stacioni i transferimit në Shtërpçë mund të përdoret po ashtu nga komunat. Këto komuna mund të investojnë së bashku për të krijuar një objekt modern.

5

Një mënyrë tjetër përmes së cilës mund të bashkëpunojnë komunat është krijimi i një kampanje të përbashkët të ngritjes së vetëdijes. Shumica e komunave të intervistuar kanë përmendur faktin se ato kanë probleme me qytetarët të cilët hudhin mbeturinat e tyre pa kujdes. Si rezultat, komunat mund të bashkohen forcat për të ngritur vetëdijen e qytetarëve për të zvogëluar, ripërdorur, dhe ricikluar mbeturinat.

6

Komuna e Gjilanit ka deklaruar që për shkak të mungesës së inspektorit, komuna nuk e din saktësisht dëmin që i shkaktohet nga hedhja e pakujdesshme e mbeturinave, dhe nuk mund ti ndal qytetarët të hedhin mbeturinat në mënyrë të pakujdesshme. Si e tillë, komuna mund të krijojë një marrëveshje me komunën fqinje, si për shembull Novobërdën për të ndarë shërbimet e inspektoriatit, përderisa Gjilani mund të ndajë disa shërbime tjera në të cilat ata janë të mirë. Një praktikë e tillë është implementuar në Maqedoni ku 3 komuna (Novo Selo, Vasileva dhe Bosilova) janë pajtuar që në çdo komunë të vendosin departamente të përbashkëta të cilat do të ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët e të tri komunave, duke siguruar që qytetarët të kenë qasje në këto shërbime në njësinë më të afërt. Komuna e Novo Selo-s do të ofrojë shërbime të planifikimit dhe menaxhimit urban, komuna e Vasilevës do të jetë qendra për departamentin e tatimeve dhe të dëshmisë, përderisa komuna e Bosilovo-s do të specializojë në ofrimin e shërbimeve të ndërlidhura me fuqizimin e ligjit dhe inspektimin (UNDP, 2008).

7

Një mundësi tjetër për bashkëpunim është mes komunave të Graçanicës, Obiliqit, Novobërdës, Gjilanit, Parteshit, Ranillugut dhe Klllokotit. Zyrtarë nga Graçanica kanë përmendur se janë 21 deponi ilegale në komunën e tyre, dhe se ata po përpiqen ti mbyllin duke ndërtuar një stacion transferimi. Komuna e Graçanicës po pret që idea të aprovohet nga Ministria e Ambientit. Stacioni i transferimit mund të përdoret po ashtu edhe nga komunat tjera të lartpërmendura. Kjo do të ndihmonte të zvogëlonte sasinë e mbeturinave të hedhura në deponi; do të bënte grumbullimin e mbeturinave të forta më efikas dhe do të zvogëlonte kostot e transportit të përgjithshëm, emetimit të gazrave, trafikun e kamionëve, dhe dëmtimin e rrugëve. Do të kursente para dhe do të ulte kostot e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave të ngurta për të gjitha komunat e përfshira. Stacionet e transferimit po ashtu ju japin komunave mundësinë e përzgjedhjes mes opsioneve të ndryshme të deponimit të mbeturinave dhe sigurimit të tarifave më të ulëta të deponimit.



Komunave me shumicë serbe ju ofrohet shërbimi nga institucionet paralele. Në mënyrë që të shmangim këtë dukuri, komunat mund të krijojnë një kompani publike rajonale e cila do të ishte përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave.

4.1 MUNDËSITË E PËRBASHKËTA TË NXJERRA NGA FORUMI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Forumi për Menaxhimin e Mbeturinave në 16 Komuna - Mundësitë për Bashkëpunim Ndër-komunal u organizua në fund të shkurtit 2016. Qëllimi kryesor i forumit ishte prezantimi i raportit për menaxhimin e mbeturinave dhe gjenerimi i ideve të reja për mundësitë për bashkëpunim ndër-komunal. Në forum ishin të ftuar zyrtarët komunal të cilët janë përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në 16 komunat e përzgjedhura. Zyrtarët u inkurajuan të japin ide për bashkëpunim ndër-komunal që mund të zbatohen me sukses. Përveç zyrtarëve komunal, të pranishëm në forum ishin edhe drejtorët e kompanive rajonale për menaxhimin e mbeturinave, shoqëria civile dhe një zyrtar nga Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. Është e rëndësishme të theksohet se idetë për bashkëpunim ndër-komunal të paraqitura në raport janë vlerësuar si shumë të mirë dhe lehtë të zbatueshme. Megjithatë, zyrtarët komunal kanë shtuar se me procesin e decentralizimit, niveli qendror ka kaluar përgjegjësinë e menaxhimit të mbeturinave në nivelin lokal pa menduar në lidhje me qëndrueshmërinë. Komunat nuk ishin të gatshëm të pranojnë këtë lloj të përgjegjësisë pasi ato nuk i kishin dhe ende nuk kanë burime financiare dhe njerëzore të nevojitura për menaxhimin e mbeturinave në mënyrë sa më efektive. Për më tepër, shumë pak aktivitete janë ndërmarrë nga niveli qendror për të forcuar nivelin lokal në mënyrë që komunat të ofrojnë shërbime në mënyrë të qëndrueshme. Si rezultat, komunat përballen me shumë probleme në menaxhimin e mbeturinave dhe duhet të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për të përmirësuar situatën aktuale.

Idetë e nxjerra nga forumi lidhur me bashkëpunimin ndër-komunal janë si më poshtë:



Ideja e parë e propozuar për bashkëpunim ndër-komunal ishte ndërtimi i objekteve të përbashkëta të kompostimit. Rreth 45 deri 50 përqind e mbeturinave të prodhuara nga një familje janë organike. Ato mbeturina hidhen së bashku me llojet e tjera të mbeturinave dhe përfundojnë në deponi, ku dekompozohen dhe lirojnë gaz metani. Kompostimi do të ndihmojë njësitë familjare për të ulur sasinë e mbeturinave që ata hedhin. Si rezultat, edhe sasia e mbetjeve të deponuara në deponi do të ulej. Gjithashtu, sasia e mbetjeve të transportuara do të ulej. Kompostimi kontribuon gjithashtu pozitivisht në mbrojtjen e mjedisit, pasi që konsiderohet si riciklim. Prandaj, komunat në Kosovë mund të investojnë së bashku për të krijuar objekte moderne për kompostimin e mbeturinave organike. Mbeturinat e kompostuara mund të përdoren si pleh për tokë.



Ideja e dytë e propozuar për bashkëpunim ndër-komunal ishte investimi nga katër komunat veriore, Mitrovica Veriore, Leposaviqi, Zveçani dhe Zubin Potoku, në një fabrikë të përbashkët të riciklimit. Asnjë nga komunat nuk i kanë burime financiare të nevojshme për të investuar vetë në një fabrikë të tillë. Si rezultat, ato mund të investojnë së bashku për të ndërtuar një fabrikë të riciklimit.



Ideja e tretë e propozuar për bashkëpunim ndër-komunal ishte gjetja e një zgjidhje të përbashkët për rritjen e përqindjes së inkasimit të taksës për grumbullimin e mbeturinave. Pothuajse të gjitha komunat kanë cekur se ofrimi i shërbimit të menaxhimit të mbeturinave është i kushtueshëm dhe se inkasimi është në nivel shumë të ulët, duke ndikuar në këtë mënyrë negativisht në shërbimin e ofruar. Rrjedhimisht, komunat mund të krijojnë politika të përbashkëta që do të ndikojnë në mbledhjen e taksës. Komunat mund caktojnë modele ekonomike të ndryshme sa i përket pronësisë së kompanive përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave. Në vend se kompanitë të jenë plotësisht publike ato mund të kenë pronësi publiko-private.



Ideja e katërt e propozuar për bashkëpunim ndër-komunal ishte bashkimi i mjeteve financiare nga ana e komunave për blerjen e pajisjeve të nevojshme për mbledhjen e mbeturinave dhe pastrimin e rrugëve. Pothuajse të gjitha komunat janë ankuar se pajisjet e përdorura janë të vjetra dhe kompanitë rajonale nuk kanë burime financiare për të blerë pajisje të reja. Si rezultat, komunat mund të bashkojnë forcat për të blerë pajisje të reja të cilat emitojnë më pak gazra dhe do ta bënin transportin në deponi më efektiv.



Ideja e pestë e propozuar për bashkëpunim ndër-komunal ishte zbritja e numrit të deponive rajonale nga shtatë (7) në dy (2). Ideja kryesore është që të jenë dy deponi rajonale që menaxhohen në mënyrë efektive dhe efikase në vend që të jenë shtatë deponi në kushte të tmerrshme. Mund të krijohen dy deponi të reja të cilat i plotësojnë të gjitha kriteret e kërkuara. Këto deponi duhet të mirëmbahen si duhet. Qëllimi kryesor me uljen e numrit të deponive do të jetë ulja e sasisë së mbeturinave të prodhuara nga qytetarët.

REFERENCAT

Association of Kosovo Municipalities. 2010. ***Inter-municipal Cooperation in Kosovo Challenges and Opportunities.*** IMC REPORT

Association of Municipalities in the Republic of Croatia. 2010. ***Inter-municipal cooperation in the republic of Croatia: Legislative, Institutional and Financial Framework for Inter-Municipal Cooperation and Examples of Good Practice.***

Institute for Democracy and Mediation. 2013. ***Inter-municipal Cooperation as an alternative towards Efficient Public Service Delivery in Albania.***

Local Development Group. 2006. ***Inter-municipal Cooperation in Planning and Service Delivery: Analysis and Recommendations***

OSCE Spillover Mission to Skopje. 2004. ***A Report on the Status of Inter-Municipal Cooperation***

Republika e Kosovës/Republic of Kosovo. 2008. ***Law Nr. 03/L-040 on local self-government.*** Retrieved from: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_en.pdf

Republika e Kosovës/Republic of Kosovo. 2008. ***Constitution of the Republic of Kosovo.*** Retrieved from: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/Constitution1%20of%20the%20Republic%20of%20Kosovo.pdf>

United Nations Development Programme (UNDP) Montenegro and Ministry of Interior and Public Administration of Montenegro. 2010. ***Strengthening Inter-Municipal Cooperation in Montenegro.***

United Nations Development Programme (UNDP) Macedonia and Government of the former Yugoslav Republic of Macedonia. 2008. ***Inter-municipal partnerships for improved public service quality.***

SHTOJCA 1

	Gjilan	Istog	Klina	Obiliq	Peja	Vushtrri	Graçanica	Kllloko	Leposaviç	Mitrovica e Veriut	NovoBërdë	Partesh	Ranillug	Shtërpce	Zubin Potok	Zveçan
Niveli i ulët i vetëdijësimit nga gytetarët	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Deponi të vjetra	✗			✗	✗	✗										✗
Nuk kanë deponi i									✗	✗					✗	✗
Niveli i ulët i mbledhjes së mbeturinave	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Mungesa e anëtarit të bordit në kompani		✗	✗				✗				✗					
Mungesa e një kompanie përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave								✗	✗	✗		✗	✗	✗	✗	✗
Mungesa e burimeve për të klasifikuar mbeturinat	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Mungesa e burimeve për të ricikluar mbeturinat	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗
Mungesa e stacioneve të transferimit	✗	✗		✗	✗		✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗		✗
Pajisjet e vjetra		✗	✗	✗		✗	✗		✗	✗				✗	✗	✗
Niveli i ulët i mbledhjes së taksave						✗	✗	✗	✗	✗	✗	✗		✗	✗	
Deponia menaxhohet nga një organizatë tjetër	✗			✗	✗		✗				✗					
Niveli i ulët i mbulimit të territorit		✗		✗								✗				
Mungesa e planit për menaxhimin e mbeturinave												✗				✗
Mungesa e burimeve financiare për "zbatimin e planit"		✗				✗		✗		✗			✗			

SHTOJCA 2

#	Komuna	Emri & Mbiemri	Pozita
1.	Gjilan	Fehmi Agushi Fadil Osmani	Zyrtar për Mbrojtjen e mjedisit Zyrtar për Zhvillim Ekonomik
2.	Pejë	Uke Selimaj	Drejt看 për Shërbime Publike
3.	Obiliq	Burim Gerguri	Drejt看 për Shërbime Publike
4.	Istog	Bedri Hasani	Drejt看 për Shërbime Publike
5.	Vushtrri	Sami Istrefi Islam Latifi	Drejt看 për Zhvillim Urban dhe mbrojtje të ambientit Zyrtar për Shërbime Publike
6.	Klinë	Xhoke Lleshi	Drejt看 për Shërbime Publike
7.	Graçanica	Dejan Jovanović Vladica Trajković	Drejt看 për Zhvillim Urban , Planifikim, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit Drejt看 për Shërbime Publike , Bujqësi, Pylltari dhe Emergjencia
8.	Ranillug	Ivan Janićijević	Drejt看 për Shërbime Publike
9.	Shtërpë	Siniša Budurić	Drejt看 për Shërbime Publike , Mbrojtje dhe Shpëtim
10.	NovoBërdë	Nebojša Arsić	Drejt看 për Shërbime Publike
11.	Klllokot	Hasan Rashiti	Zëvendës Kryetar
12.	Partesh	Živojin Cvetković	Drejt看 për Shërbime Publike dhe Mbrojtje
13.	Zubin Potok	Dejan Radojković	Drejt看 për Shërbime Publike
14.	Leposaviq	Goran Lazović	Kompania Publike Komunale “24 novembar”
15.	Mitrovica e Veriut	Jelena Milenković	Zyra administrative në Mitrovicën e Veriut
16.	Zveqan	Nadica Hristov	Drejt看 për Zhvillim Urban



USAID
NGA POPULI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA



